



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOS.  
QENDRA PER SHERBIM TE QY  
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 23772  
U. Br.

Nr. i faq. 6 Data: 25/07  
Br. str. Datum: 2024

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS  
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



## Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor në fshatin Kopërnice

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

### Publikimet:

### UEBFAQE:

### FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=885035050325495&set=pcb.884989316996735>

### PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:

Me 08.07.2024 dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Kopërnice duke filluar nga ora 18:10.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtori i Urbanizmit, Uran Berisha, Drejtori për Investime Kapitale, Blerim Morina, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqësin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shumë të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojmë një draft buxhet për vitin e ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro ku do të ketë një rritje prej 5.10%, krahasuar me vitin 2024, ku pjesa e dedikuar për investime kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishme në fshatin Kopërnice.

Më pasë Zëdhënsja e Komunës, Lidiona Marovca, ka prezantuar punët që janë bërë vitin e kaluar dhe janë në process për këtë vitë: njëra nga projektet e mira që ka përfituar fshati kopërnice është edhe smart TV që I kanë vendosur nëpër secilen shkollë, më pas po punohet në platformën komunale për shkolla, rekuzita sportive, furnizimi I shkollës me laptop, instalimi I sistemit të internetit si dhe instalimi I kamerave të siguris, ndërtimi i trotuari, zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik rr. "Rexhep Beqiri" dhe rr. "Ibrahim Ismajli", investimi në ujra të zeza, nga fshatin Kopërnice ka pasur edhe banor që kanë qenë përfitues edhe të granteve, subvencioneve si dhe katër banor kanë përfituar bursa për student. Si dhe rrugët e reja që janë futur në proces të asfaltimit janë: rr. "Syl Ademi", rr. "Lelenci", rr. "Xhaqku", rr. "Ismet Hasani", rr. "Durrësi", rr. "Lapidari", rr. "Dëshmorëve", rr. "Shkollës", si dhe rr. "Ibrahim Ismajli", janë rrugë që janë në procesin e tenderimit dhe së shpejti do të fillojnë punimet me përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

### **Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:**

Kryetari i Kshillit Lokal Endrit Beqiraj: Sa i përket kshillit I kemi disa kërkesa që I kemi marë nga banorët e fshatit e që janë kërkesa që është bërë dhe kryesore, të bëhet një pikë grumbullimit të mbeturinave, të hiqen mbeturinat inerte, sepse ktu kan pru nga vendet tjera dhe na e kan blloku lumin, trotuari i fshtatit nga varresat deri te bunari i Zenelit, hapja e një rruge te re per te kala e fshatit, ndriqimi nga shkolla deri te parku I ri, Rrethoja e fushës se sportit, sepse është rrezik për jetë, sa I përket kërkesave këto ishin kërkesat e kshillit lokal. Nëse ka edhe nga banorët të I tregojnë edhe ata kërkesat e tyre.

Banori Remzush Beqiraj: rruga e Dëshmorëve cila rrugë është? Si dhe rruga e Shkollës dhe rruga e Durrësit, a është asfaltim apo ndriqim? Në vitin e kaluar ka qenë kërkes për ndriqim në rrugën e Durresit, ndërsa asfaltim nuk ka nevojë.

Drejtori I Urbanizmit Uran Berisha: rrugë kryesore që kanë degësime të shkurta, degësimet e shkurta nuk kanë emër të vetin por e kanë emrin e rrugës kryesore dhe sigurisht është fjala që dalin prej sokakeve që dalin në rrugën kryesore, sepse sipas ligit të emërtimit të rrugëve, rrugët të cilat janë më të shkurta se 100m dhe që nuk I kanë së paku 10 shtëpi nuk guxon me pas emër. Sa I përket rrugëve që kanë me u asfaltu dhe janë në listë, janë aty ku nuk ka infrastruktur përcjellëse, si ndriqimi kanalaizimi dhe asfaltimit, dhe sigurisht që nëse ekziston afaltimi ka me u bë vetëm ndriqimi.

Banori Leutrim Ajvazi: Rruga Rexhep Rama, shtrimi i kanalit atmosferik, si dhe zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik, 110m gjatësi.

Banori Xhevdet Rexhepaj: pastrami i deponis ilegale të mbeturinave te penda dhe vendosja e kamerave.

Banori Muharrem Ismajli: Riparimin e shkollëve të shkollës, dhe mjete e mirëmbajtjes kam kërkuar disa herë, vendosja e kamerave në shkollë nuk është bërë asgjë për shkollën tonë, ne I kemi vetëm 6 llaptopa te shkolla jonë, furnizimin e shkollës me llaptop, janë edhe 3 klasë për smart TV, rrethoja e fushës së shkollës. Këto janë prioritet shkollët dhe mjete e punës për mirëmbajtje.

Drejtoresha Arditë: unë të përgjigjina sa I përket rregullimit të shkollëve, ne kemi ba një marrveshje për renovimin e objekteve komunale ky hyn edhe shkollat, bëje një kërkes tek Drejtoria e Arsimit për renovim të shkollave.

Banori Ramadan Beqiraj: Nga ana juaj shihet një atmosfer e punës mirëpo ne qytetarët nuk jemi të kënaqur, duke u nisë nga institucioni më i lartë i njëzimit siq është shkolla nuk është në rregull me asgjë, për një makin për mirembajtje nuk është në gjendje komuna me e siguru, fushës së sportit i nevojitet një rrethoj, e tmerrshme dhe e dhimbshme është gjendja e shkollës me të cilen mësojnë nxënësit, renovim i shkollës nuk është bërë asnjëher, izolim i shkollës, rregullimi i trotuarit vazhdimi i saj deri në kodër si dhe ndriqmi public, rrethoja e shkollës, ndrrimi i dritareve të shkollës, heqja e deponis ilegale të mbeturinave te penda nga fshatrat e tjera binë mbeturina ktu te ne, asfaltimi dhe hapja e rrugës te kalaja. Ju kisha lutur juve që këto kërkesa të shkojn tek kryetari dhe të kryhen punët që janë më urgjente. Emërtimi i rrugëve që është bërë para 10 viteve, kanë manipuluar njëzitet me listen që ne e kemi dërguar, kanë bërë ndryshim në emertime të rrugëve për qfar arsye janë bërë ndrrimi i emrave, shtylla të futbollit për shkollën.

Drejtori Uran Berisha: ne kemi pas shum kërkesa për ndrrimin e emrave ka pas shumë paknaqësi, dhe kemi pas takim me Agjensioni Kadastral të Kosovës dhe na kanë thanë që nëse doni me fillu me ndrrimin e emrave të rrugëve duhet të miren nga lista rezervë, që edhe ajo listë është miratu në të njëjtin vit, ne nuk guxojm me pru emër të ri nëse nuk është në listën rezerv të emrave, nëse është emir në listën rezerv mundeni me fillu me procedurat e ndërrimit të emrit. Rrethojat e shkollës në kuadër të renovimit të objekteve publike hyn edhe shkollat, dhe mundeni me kërku për rregullimin e rrethojës së shkollës, shkallët si dhe fushën e shkollës.

Banori : Heqja e deponisë ilegale të mbeturinave në fshat, është shumë e rrezikshme sepse kundërmon er si dhe rreizshmëria nga kallja e mbeturinave, kundërmimi i erës vjen deri tek shtëpia jon dhe është e padurueshme.

Banori Remzush: në rastin e deponis së mbeturinave kemi marë iniciativë që të hiqet dhe te ndërtohet një park në atë vend, mirëpo tash është bërë e pa durueshme sepse është mbushë. Kërkoj nga komuna që të pastrohet dhe të vendosen kamera.

Banori Burhan Beqiraj: rruga Rahim Beqiraj , janë 20 bandera të cilat janë të drurit dhe duhet të ndërrohen.

	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Endrit Beqiraj	Caktimi i një vendi të deponis së mbeturinave, Heqja e deponis ilegale te lumi I fshatit, Rregullimi i trotuarit nga varrezat e fshatit deri te Bunari I Zenelit, Hapja dhe zgjerimin e rrugës te Kalaja,	Me telefon


		Ndriqimi public nga shkolla deri te Parku i ri, Rrethoja e fushës së sportit,	
2.	Remzush Beqiraj	Ndriqimi publik I rrugës “Durrësi”, Pastrimi I deponisë ilegale dhe vendosja e kamerave.	Me telefon
3.	Leutrim Ajvazi	Shtrimi I kanalit Atmosferik, si dhe zgjerimi I rrjetit të ndriqimit publit, rr.”Rexhep Rama” 110m gjatësi.	Me telefon
4.	Xhevdet Rexhepaj	Pastrimi I deponisë ilegale të mbeturinave te penda dhe vendosja e kamerave.	Me telefon
5.	Muharrem Ismajli	Riparimi I shkallëve të shkollës, Mjete e punës për mirmbajtje të oborrit të shkollës, Rrethoja e fushës së sportit, Vendosja e kamerave në shkollë, Vendosja e 3 Smart Tv në klasa, Llaptop .	Me telefon
6.	Ramadan Beqiraj	Renovimi I shkollës I mbrendshëm dhe I jashtëm, izolimi I shkollës, Mjete e punës për mirëmbajtje, Rrethoj për fushën e sportit, Rrethoja e shkollës, ndrrimi I dritareve, shtylla të futbollit, Vazhdimi I trotuarit deri në kodër, si dhe Ndriqimi public, Heqja e deponisë ilegale te penda, Asfaltimi dhe hapja e rrugës te Kalaja,	Me telefon
7.	Banori	Heqja e deponisë ilegale te penda,	Me telefon
8.	Burhan Beqiraj	Heqja e 20 shtyllave elektrike dhe vendosja e shtyllave të reja, rr. “Rrahim Beqiraj”	

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 19:07.

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi





Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në fshatin Kopërnice

Data: 08.07.2024

Ora: 18:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi <sup>12</sup>
1.	Ejup Rehimaj			M	SH	
2.	Muharrem Ismajli			M	shqiptar	
3.	Suzel Rehimaj			M	Shqiptar	
4.	RIAD RAHMANI			M	Shqipar	
5.	Yvudon Rexhepaj			M	SH.	
6.	ZEKIRIJA BEGIRAJ			F	SH	
7.	Abdore Begiraj			F	sh	
8.	Zulfi Begiraj			M	Sh	Z. Begiraj
9.	Andri Ismajli			M	SH	
10.	BURHAN BEGIRAJ			M	SH	
11.	Xhevdet Rehimaj			M	Shqiptar	
12.	Ramadan Begiraj					
13.	Yutrim Avdovaj			M	SHqiptar	
14.	Endrit Begiraj			M	SH	
15.	Kemal Rexhepaj			M	shqiptar	
16.	Xhevdet Avdovaj			M	shqiptar	

<sup>1</sup> SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

<sup>2</sup> SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunojë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi <sup>12</sup>
17.	Seydi Baglimaj	—		M	SLA	SB
18.						
19.						
20.						
21.						
22.						
23.						
24.						
25.						
26.						
27.						
28.						
29.						
30.						
31.						
32.						
33.						
34.						
35.						
36.						
37.						
38.						
39.						

<sup>1</sup> **SHQ:** Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB:** Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

<sup>2</sup> **SHQ:** Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përdorë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.